



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 46 datë 06.07.2016

**Për**

**“Miratimin e dhënies së ambientit në përdorim Organizatës Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve - ARSIS, për një periudhë 1-vjeçare, me destinacion për qendër sociale, në zbatim të Projektit “Ngritja e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë, nëpërmjet vënies në punë të qendrës multidisiplinare në Njësinë Administrative nr. 7”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “a” dhe pika 1/1.2, shkronja “a”, nenit 24, pikat 1 dhe 3, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 901 dhe në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 8, nenit 121, pika 1, nenit 124, pika 1, nenit 125 dhe nenit 126, pika 1 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 10.8.1992, “Për mënyrën e klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore në kombëtare ose lokale”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.01.2012, “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkiak Bashkiak nr. 69, datë 20.12.2005, për “Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 46, datë 28.07.2007, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore për të cilat Bashkia e Tiranës kërkon transferimin në pronësi të saj”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 10.8.1992, “ Për mënyrën e klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore në kombëtare ose lokale” dhe të vendimit të Këshillit Drejtues të Oficinës së Automjeteve Tiranë nr. 09 prot., datë 04.03.2016, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtim, për Organizatën Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve - ARSIS, për një periudhë 1-vjeçare, të ambientit me sipërfaqe të trualli Str =1280.0 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi Snd. = 633.6 m<sup>2</sup> të Ndërmarrjes Oficina e Automjeteve të Transportit Nd.Sh.a (sipas Planimetrisë bashkëngjitur).

2. Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 6, datë 12.02.2015 për “Miratimin e dhënies së ambientit në përdorim organizatës shoqërore të përkrahjes së të rinjve – ARSIS, me destinacion për qendër sociale, në zbatim të projektit “Qendër e qëndrueshme shumëdisiplinare në Njësinë Bashkiake nr. 7”” revokohet.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Ndërmarrja Ofiçina e Automjeteve të Transportit Nd.Sh.a.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit te Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**